

## RAPORTI MONITORUES

### PËR ZBATIMIN E UDHËZIMIT TË KQZ NR. 1, DT 31/05/2017 “PËR PËRDORIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE VENDET PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Shqipëria hyri ne zgjedhjet e pergjithshme parlamentare te Qershorit 2017 me një kuader ligjor te ndryshuar si rezultat i marrveshjes se arritur mes dy forcave kryesore politike ne vend, PS dhe PD. Ligji per Mediat, Ligji per Partite Politike dhe Kodi Penal u ndryshuan në datë 22 maj 2017 në seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Shqipërisë. Të treja ligjet e ndruara në këtë seance hynë në fuqi me procedurë të procedurë të përshpejtuar, duke mos i lënë hapësirën e duhur njohjes efektive të ndryshimeve ligjore palëve të interesuara.

Forcat kryesore vendimarrëse në Kuvend nuk prekën Kodin Zgjedhor të RSH, duke mos aktivizuar në këtë kuptim asnjë komponent të reformës zgjedhore, pavarësisht rekomandimeve të aktorëve vendas dhe atyre ndërkombëtare që mbikqyrin proceset zgjedhore në RSH.

Në reflektim të situatës ligjore të ndryshuar, konkretisht në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KQZ, nxorri në data 31 Maj 2017 udhëzim nr.1 “*Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore*”. Ky udhëzim kishte për qëllim të përcaktonte kufizimet në përdorimin e materialeve propagandistike statike dhe vendndodhjet e lejuara për afishimin e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, duke detajuar tashmë normën ligjore të fiksuar nga aktorët parlamantare për mos-përdorim të materialeve propagandistike në fushatë zgjedhore.

Sipas këtij udhëzimi, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor. Përdorimi i materialeve propagandistike statike, jashtë parashikimit të fjalisë së dytë të kësaj pike është i ndaluar.

Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat. Subjekti zgjedhor është i detyruar që brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi të njoftojë me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse, adresat e sakta të zyrave elektorale. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit administrata e bashkisë, bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.

Bashkia, nëpërmjet organeve të zbatimit të ligjit në varësi të saj, është e detyruar të heq të gjitha materialet propagandistike që janë afishuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim. Cdo shpenzim për materiale propagandistike statike i kryer nga subjektet zgjedhore jashtë kushteve dhe kriterëve të këtij udhëzimi do të konsiderohet nga KQZ si shpenzim në kundërshtim me pikën 4 të nenit 24/2 të ligjit nr. 90/2017.

Ky udhëzim nuk prekte përdorimin e materialeve propagandistike lëvizëse, nga ana e subjektit zgjedhor. KQZ-ja kur vihet në dijeni për shkelje të këtij udhëzimi nga ana e subjektit zgjedhor, urdhëron Kryetarin e Bashkisë, për heqjen e materialeve të afishuara në kundërshtim me dispozitat e këtij udhëzimi. Kryetari i bashkisë është i detyruar të raportojë brenda 24 orëve, për zbatimin e urdhërimit të KQZ-së. Në rastet e kundravajtjeve administrative, KQZ vendos sanksionet administrative të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

## **Protokolli i vlerësimit**

Gjatë periudhës 15-25 Qershor 2017, INFOCIP, anëtare themeluese e Dhomës Zgjedhore, ndërmoi një monitorim në terren për të verifikuar kushtet e zbatimit të Udhëzimit të KQZ nr1/ dt 31/05/2017 në tre bashki të qarkut Tiranë, konkretisht Tiranë, Kamëz dhe Vorë. Sa i takon bashkisë Tiranë, INFOCIP monitoroi territoret në pjesën Veriore të saj, veri-lindore, Lindore dhe Juglindore (gjithë pjesa e qytetit dhe fshatrat që janë mbi bulevardin “Dëshmorët e Kombit”). Pjesa tjetër e kryeqytetit u monitorua nga partnerët në këtë projekt (ISP).

Zona e Kamzës, në të gjitha njësite administrative përbërëse (qytete,, fshat Lokalitet) u mbulua plotësisht me monitorim nga INFOCIP, sikurse edhe bashkia Vorë (plotësisht pjesa urbane dhe 80% e territoreve ruralë të kësaj bashkie).

Monitorimi u realizuar në partneritet me Zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë, me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve si dhe me Dhomën Zgjedhore (organizatat e saj përbërëse).

Për të realizuar një vlerësim koherent dhe objektiv të zbatimit të këtij udhëzimi, INFOCIP vendosi që të disponoheshin paraprakisht:

1. Harta e saktë e lagjeve të qytetit/fshatrave të një bashie të caktuar, në të cilën të jenë të përcaktuar kufijtë ndarës/administrativë.
2. Fotot e marra në terren nga grupet e monitorimit apo vëzhguesve të akredituar në KQZ.
3. Vlerësimi sistematik i distancave fizike brenda të cilave udhëzimi përcakton vendosjen e materialeve proagandistike zgjedhore.
4. Kërkesat e vetë subjekteve zgjedhore të depozituara sipas kërkesave të këtij udhëzimi në Bashki, përmes të cilave kjo e fundit vihet në dijeni të numrit të zyrave elektorale në territor.
5. Çdo e dhënë e vënë në dispozicion nga bashkia lidhur me monitorimin që ajo realizon, konform kërkesave të udhëzimit nr1/ dt 31/05/2017

INFOCIP trajnoi dhe nxorri më pas në terren grupet e monitoruesve, të cilët të pajisur me mjete lëvizëse dhe me aparatura dixhitale që dokumentojnë vendodhejen me “geo-location” vunë në zbatimin protokollin e monitorimit. Vlerësimi u bë në dy raunde, me grupe të alternuara, duke konsoliduar në vazhdim rezultatet e vëzhgimit në terren. Në fillim u prioritarizua me mbulim zona urbane e bashkitë e lart-shënuara dhe në pas edhe territoret rurale respektive.

## Rezultatet e monitorimit

Në territorët e të treja bashkitë të monitoruara, Tiranë, Kamëz dhe Vorë u vëzhguan dhe u dokumentuan me foto:

43 zyra te PD  
50 zyra te PS  
38 zyra te LSI  
12 zyra te PDIU  
1 zyre e LIBRA  
1 zyre e PSD

Ne total u dokumentuan me foto dhe *geo-location* 145 zyra elektorale.

- Ne Bashkinë Tiranë, në territorin e marrë për shprehje për mbulim nga INFOCIP (pjesa mbi bulevardin deshmiret e Kombit, pra në lindje dhe në jug-lindje të qytetit) gjithsej u vëzhguan 15 zyra PD, 28 zyra PS, 16 zyra LSI, 9 PDIU, 1 LIBRA
- Ne Bashkinë Kamëz gjithsej u dokumentuan 22 zyra PD, 13 PS, 10 LSI, 1 PSD dhe 3 PDIU
- Ne Bashkinë Vorë u dokumentuan 6 zyra elektorale të PD, 9 të PS dhe 12 të LSI

Nga monitorimi rezultoi se në përgjithësi udhëzimi i KQZ është respektuar sa i takon distancave të parashikuara për përdorimin e materialeve propagandistike të partive për objektet e monitoruara nga INFOCIP (neni 2, paragrafi 1). Në asnjë rast të dokumentuar

Nga monitorimi në terren rezultuan disa raste kur një subjekt zgjedhor kishte me shumë se një zyre elektorale për lagje/fshat. Konkretisht në zonën lindore, verilindore dhe juglindore të kryeqytetit Tiranë (mbi kufirin urbanistik që cakton bulevardin qendror), u konstatuan 10 raste shkelje të kësaj dispozite nga subjekti zgjedhor PS, 4 raste të shkeljes nga subjekti zgjedhor PD, dhe 5 raste nga subjekti zgjedhor LSI.

Nga vlerësimi rezultoi se subjektet zgjedhore kanë bërë shkelje të dispozitave të këtij urdherimi sa i takon njoftimit paraprak me shkrim të bashkive sa i takon referimit të adresës së saktë dhe numrit të përgjithshëm të pikave të propagandës zgjedhore. Konkretisht rezultoi se në Bashkinë Tiranë ka depozituar kërkesë konform këtij udhëzimi vetëm subjekti zgjedhor PS. Në bashkinë Kamëz ka depozituar kërkesë konform këtij udhëzimi vetëm subjekti zgjedhor PD. Në bashkinë Vorë ka depozituar kërkesë vetëm subjekti zgjedhor PD. Vihet re një tendencë në këtë rast që direktivën e depozitimit të listave e kanë plotësuar ato subjekte zgjedhore të cilat kanë patur afiliacion politik me drejtimin e bashkisë përkatëse. Të gjitha subjektet e tjera zgjedhore që kandiduan në këto tre bashki (qarku Tiranë 13-15 subjekte), nuk e kanë respektuar Udhëzimin nr. 1 të KQZ.

Të dhënat për dokumentacionin e depozituar në bashki nga subjektet zgjedhore INFOCIP e ka disponuar përmes aktivizimit të dispozitave të ligjit 119/2014 për të drejtën për informim. Të

treja bashkitë të cilat morën kërkesa për këtë qëllim iu përgjigjen me shkrim dhe/ose me email zyrtar, brenda afateve ligjore të lejuar, kërkesave të depozituara nga INFOCIP.

Nga monitorimi rezultoi se Bashkitë nuk kanë mundur gjithashtu të përmbushin detyrimet e tyre për të autorizuar conform vlerësimevetë tyre paraprake planin e vendosjes së zyrave elektorale sipas listës të paraqitur nga subjektet zgjedhore. Koha e pakët në dispozicion si dhe dinamika e fushatës, në të cilët vetë bashkitë u përshinë në nivel të përfaqësuesve të tyre politike, por edhe klima e çtensionuar parazgjedhore që prodhoi Marrëveshja Politike PS-PD në datë 18 Maj 2017, mund të renditen si disa nga shkaqet e mos-veprimit të bashkive në drejtim të zbatimit të urdhërimeve të KQZ.

INFOCIP ka konstatuar gjithashtu një defekt edhe në formulimn e vetë Udhëzimit të KQZ sa i takon njësive territoriale të referuara si kritere të vendosjes së zyrave të propagandës zgjedhore. Konkretisht, paragrafi 2 i nenit të udhëzimit është i formuluar në këtë formë: "Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat". Aktualisht, bashkitë nuk disponojnë harta të ndarjeve me bazë lagje, por vetëm të njësive administrative. INFOCIP bëri kërkesë pranë zyrës urbanistike të treja bashkive për të disponuar kufijjtë e lagjeve, por jko e dhënë ishte e pamundur të gjenrohej në pak kohë që u la në dispozicion të këtij monitorimi. Sa i takon qytetit të Tiranës, koncepti lagje ka humbur me kohë konsistencën e vet dhe sot nuk referohet më. Edhe emrat ë përdoren janë trivialë (psh. "Te Brylli", "Te 21-shi").

Edhe sa i takon kriterit të KZQ "Një qendër elektorale për fshat" përsëri i aka krijuar vështirësi në vlerësim. Bashkia Kamëz psh është e përbërë nga dy NJA, Kamëz dhe Paskuqan. NJA Kamëz ka gjithsej 5 lagje, plus Bathorja qe ka 7 lagje me vete, si dhe 5 fshatra perreth, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner. Kurse NJA Paskuqan ka gjithsej 12 lagje. Në këto lagje janë të integruara fshatrat Babrru Qëndër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër. Në kushte optimale, konform përcaktimeve të udhëzimit nr.1, dr 31/05/2017 të KQZ, do të duhet që në territorin e bashkisë Kamëz të kënenë vendosur jo më më shumë se 41 zyra elektorale për çdo subjekt zgjedhor. INFOCIP ka kerkuar nga Bashkia Kamez harten e perditesuar te lagjeve, sipas ndarjes me te fundit Administrative-Territoriale.

Në pamundësi për të patur një ndarje në hartë të detajuar me bazë lagje, monitorimi u limitua në kontrastimin e lagjeve/fshatrave në total dhe zyrave/qendrave elektorale të hapura në total.

Gjetjet e këtij monitorimi u prezantuan dje nga drejtori I INFOCIP, Gerti Shella, në një tryesë të rrumbullakët të organizuar nga Këshilli i Europës dhe KQZ në mjediset e Hotel Tirana, në kuadër të projektit "Veprimi kundër Krimin". Në tryezën me teme "Monitorimi i financimit të fushatës zgjedhore" u prezentuan edhe rezultatet e bashkëpunimit të Këshillit të Evropës dhe mbështetjes së ofruar ndaj KQZ-së në funksion të përgatitjes së zgjedhjeve parlamentare. Po ashtu u prezantua edhe Dokumenti Teknik i Këshillit të Evropës "*Rekomandime për të forcuar dhe përmirësuar kuadrin rregullator, procedural dhe metodologjik të Komisionit Qendror Zgjedhor të Shqipërisë*";